



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025 | Nr: 114 | Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 20 ID, DATË 17.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: **Zj. Ardita Kuçi**
Drejtore i Përgjithshëm, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ;

Z. Ilir Ajdini
Drejtore i Përgjithshëm, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

Z. Ali Kaxhaja
Drejtore, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë;

Z. Vullnet Gjolla
Drejtore, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë;

Z. Pjerin Spathari
Drejtore, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër;

Z. Gentian Selami
Drejtore, Agjencia Kombëtare e Duhan – Cigareve;

Zj. Jonida Boçi
Drejtore i Përgjithshëm, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë



OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të Institucioneve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

K O N S T A T O J :

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 17.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 20 ID, në datën 17.02.2025.

Në këtë denoncim KRIIK parashtroi sa vijon:

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në Facebook e Institucioneve të mëposhtme, Institucione këto në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
- Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë;
- Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë;
- Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër;
- Agjencia Kombëtare e Duhan – Cigareve;
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”.

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Zj. Ardita Kuçi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
- Z. Ilir Ajdini, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
- Z. Ali Kaxhaja, Drejtor i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë;
- Z. Vullnet Gjolla, Drejtor i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë;

- Z. Pjerin Spathari, Drejtor i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër;
- Z. Gentian Selami, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Duhan – Cigareve;
- Zj. Jonida Boçi, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

